

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

URDHËR

Nr. 171, Datë 01/12 2021

**MBI**

**“ZHVILLIMIN E ANALIZËS VJETORE TË PUNËS  
PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 32, nenit 38, nenit 39, nenit 49, Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” të MASR si dhe nenit 24, Funksionet e Senatit Akademik të UART, nenit 29 Rektorati, nenit 30 Komisionet e Përhershme, neni 48 Funksionet e Bordit të Administrimit, neni 147 Raportimi të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Njësitë kryesore, njësitë bazë, drejtoritë, degët/sectorët në Universitetin e Arteve, të përgatisin dhe të zhvillojnë analizën vjetore të punës, për vitin akademik 2020-2021, **brenda datës. 15. 12. 2021.**
2. Fakultetet e Universitetit të Arteve, materialin e analizës vjetore **mbi veprimtarinë akademike**, ta dorëzojnë në zyrën e protokollit **brenda datës 15.12.2021**, dhe në formë elektronike në adresën e emailit: [zvrektor.mes@uart.edu.al](mailto:zvrektor.mes@uart.edu.al).
3. Drejtoritë, degët/sectorët në Universitetin e Arteve, materialin e analizës vjetore të punës, **për veprimtarinë administrative** ta dorëzojnë në zyrën e protokollit, **brenda datës 15.12.2021**, dhe në formë elektronike në adresën e emailit: [zvrektor.mes@uart.edu.al](mailto:zvrektor.mes@uart.edu.al).
4. Analiza vjetore e njësisve kryesore, njësisve bazë, drejtorive, degëve/sectorëve në Universitetin e Arteve, të përqendrohet në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin akademik 2020-2021, **sipas funksioneve të tyre** të shoqëruara me dokumente, shifra, statistika, etj., në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” të MASR.

5. Për përgatitjen e Raportit të Analizës Vjetore të Punës për vitin akademik 2020-2021 të Universitetit të Arteve, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ngrihet grupi i punës si më poshtë:

- Prof. Dr. Erald Bakalli Kryetar
- Prof. Arian Paço Anëtar
- Prof. Dr. Isak Shehu Anëtar
- Prof. Petrit Malaj Anëtar
- Prof. Artan Peqini Anëtar
- Znj. Alma Sinani Anëtare

6. Raporti i Analizës Vjetore i Universitetit të Arteve, i përgatitur nga grupi i punës, sipas pikës 5 të këtij urdhri, të dorëzohet në Rektorat **brenda datës 21.12.2021.**

7. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, në rubrikën “Njoftime” si dhe tu shpërndahet të gjithë instancave dhe strukturave të Universitetit të Arteve.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, të gjitha njësitë kryesore, njësitë bazë, drejtoritë, degët/sectorët, strukturat si dhe anëtarët e grupit të punës sipas pikës 5 të këtij urdhri.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**



**REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE**

